



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:034547

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05498668

A.nr.280/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe me bashkëpunëtoren profesionale Erbleta Shala, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses F..E..nga Gj..., të cilën me autorizim e përfaqëson V.. R.. avokat nga P.., kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit të datës 05.12.2022 si dhe kërkesës për kompensimin e pensioneve të papaguara, në seancën e shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur më datë 05.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses F..E..nga Gj..., të cilën me autorizim e përfaqëson V..R.. avokat nga P.. me adresë në Lagjen Kalabria rr."Jusuf Gërvalla" nr.82 hyrja IV/11-Prishtinë, si e bazuar.

II. ANULOHEN vendimet e të paditurës MPMS-DAP me numër protokollit 3432 i datës 05.12.2022, vendimi i organit të shkallës së parë i dt.02.11.2021 dhe mbetet në fuqi vendimi i datës 18.01.2013 për njohjen e të drejtës në Pensionin Bazë dhe Kontributiv.

III. Paditësja gëzon të drejtën në dy skema pensionale, atë të Familjes së viktimave Civile të Luftës dhe Pensionin Bazë sipas vendimit numër 227524 të datës 18.01.2013.

IV. DETYROHET e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, që paditëses F..E..nga Gj... në mënyre retroaktive, t'ia kompensoj pagesat për Pensionin Bazik të Moshës që nga muaji shtator 2016 deri në janar 2024 dhe atë në shumën e përgjithshme të

pensioneve mujore 17,294.00€ (shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër euro e zero cent) dhe kamatën prej 8% sipas LMD-së në shumën prej 4,733.63€ (katërmijë e shtatëqind e tridhjetë e tre euro e gjashtëdhjetë e tre cent) e në total prej 22,027.63€ (njëzetë e dymijë e njëzetë e shtatë euro e gjashtëdhjetë e tre cent), nga data e ndërprerjes së këtij pensioni deri në pagesën definitive, krejt këto në afatin prej 15 pesëmbëdhjetë ditësh, nën pasojat e përmbarimit me detyrim. Pas kësaj kohe, paditësja do të paguhet në baza mujore për dy skemat pensionale të cekura në pikën III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, Pensionit Bazë si dhe atë Familjes së viktimave Civile të Luftës, në shumën e cila do të jetë e aplikueshme për këto lloj pensione.

V. Ky Aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues.

VI. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike u mbajt konform nenit 41 të LKA-së me praninë e të autorizuarit të palës paditëse e në mungesë të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditësja me padinë e datës 08.02.2023, ka kundërshtuar aktvendimin e të paditurës, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të drejtës materiale dhe cenimit të drejtave të njeriut. Me tutje ka shtuar se nuk qëndron konstatimi i të paditurës si i drejtë që paditësja nuk mund të gëzojë pensionin bazë e drejtë kjo e garantuar për të gjithë personat që kanë arritur moshën 65 vjet. Paditësja pretendon se ka të drejtë të gëzojë edhe pensionin bazë i cili i është njohur fillimisht sipas vendimit nr.227524 të datës 18.01.2013 e ku me pastaj i është ndërprerë nga e paditura me dt.15.09.2016. Andaj, i propozon gjykatës që të i aprovohet padia si e bazuar, të anulohet vendimi i të paditurës me nr.05.12.2022 si dhe gjykata të vendosë që paditësja t'i gëzojë të dy pensionet, pasi që kjo është e drejtë e saj si dhe t'i njihet kompensimi në mënyrë retroaktive nga dita kur i është ndërprerë ky lloj pensioni.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditëses deklaroi: *"mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë me të cilën është kërkuar anulimi i vendimit të MFPT i dt.05.12.2022 dhe rrjedhimisht vendimit të MPMS-Departamenti i Pensioneve i dt.15.09.2016 me të cilën paditëses i është ndërprerë pagesa e pensionit kontribut pagues të moshës. Ekspertizën financiare e kemi pranuar dhe në të njëjtën nuk kemi vërejtje, andaj*

në bazë të përlllogaritjeve nga kjo ekspertizë bëjmë precizimin e kërkesëpadisë të cilin e dorëzojmë në formë të shkruar. Gjykatës i propozojmë që të aprovoj padinë si të bazuar”.

Ndërsa në fjalën përfundimtare deklaroi: *“pas administrimit të provave gjykatës i propozoj që të aprovoj në tërësi si të bazuar padinë dhe kërkesë padinë e paditëses F.. E.. më hollësisht të përshkruar në parashtrësën e padis të dorëzuar në këtë seancë. Konsiderojmë se kërkesa e paditëses është e bazuar dhe e ligjshme meqenëse pensioni kontribut dhënës është një e drejt e garantuar me ligj dhe kjo nuk e përjashton përfitimin e pensionit për viktimat civile të luftës i cili është një pension familjar. Kjo bazë ligjore tashmë është vërtetuar edhe me Aktgjykimin ARJ.nr.77/21 të Gjykatës Supreme të Kosovës”.*

E paditura në përgjigje në padi të datës 10.05.2023 e ka kundërshtuar padinë e paditëses si e pabazuar. Shtojnë se vendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi respektivisht nenit 16 të Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat e Financuara nga Shteti, dhe ajo në të cilën pretendon pala se vendimi është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare. E paditura ka konstatuar se paditësja është përfituese e pensionit të Viktimave të Luftës dhe se na baze të këtij ligji në asnjë rrethanë nuk mund të jetë përfitues edhe të ndonjë pensioni nga skemat pensionale. I propozon gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit si të pabazuar.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: vendimi me nr.227524 i dt.05.12.2022, ankesa e dt.24.11.2022, vendimi i dt.17.04.2008, vendimi i dt.02.11.2021, vendimi i dt.18.01.2013, vendimi i dt.29.04.2014, vendimi i dt.15.09.2016, dosja e kërkesës për pension e dt.01.11.2022, ekstrakti i gjendjes civile i dt.31.10.2022, qarkullimi për llogari i dt. te shtypjes 31.12.2022, vendimi i dt. 09.06.2016, kërkesa për pension kontributiv e dt. 25.01.2016, diploma për kryerjen e shkollës së mesme profesionale e dt.19.05 viti nuk shihet qartë, vërtetimi i dt.03.01.2009 dhe 14.01.2009, ekstrakti nga të dhënat personale dhe stazhi i sigurimit i dt.14.01.2013, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nën shenjen ARJ.nr.77/21 i dt.11.08.2021, ekspertiza financiare e dt.09.01.2024 dhe ky procesverbal i sotëm i dt.28.02.2024.

Gjykata duke vendosur në çështjen e paditëses në përputhje me nenin 43.3 të LKA-së dhe provave të administruara përgjigjes në padi në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Nuk është kontestuese se paditësja e gëzon pensionin e Familjeve Viktimave Civile të luftës. Po ashtu me vendimin e dt.18.01.2013 paditëses i është martuar pensioni bazë i moshës nga vet e paditura për të ju ndërprerë pastaj me vendimin e dt.15.09.2016.

Me vendimin e të paditurës të datës 15.09.2016, është shfuqizuar vendimi nr.227524 i datës 08.01.2013 dhe i është ndërprerë pagesa e mëtejme paditëses ne Pensionin baze të Moshës, me arsyetimin se paditësja është duke shfrytëzuar të drejtën në Pension për Familje të Viktimave Civile të Luftës, si e drejtë më e favorshme për përfituesin.

Paditësja ka paraqitur ankesë kundër këtij vendimi, tek organi i shkallës së dytë, i cili me vendimin e datës 05.12.2022 e ka refuzuar të njëjtën. Më pas, paditësi ka parashtruar padi në këtë gjykatë, duke kundërshtuar ligjshmërinë e tij.

Vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla, për shkak të te cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 47.2 përcaktohet se struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar, ku një ndër këto elemente është se *“1.Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyeën pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”*. Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i pa qartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar.

Gjykata po ashtu, iu referua Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre, i cili ka për qëllim përcaktimin e statusit dhe përkrahjen financiare përmes pensioneve dhe beneficioneve të veçanta për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, të cilat me

sakrificën dhe kontributin e tyre ishin faktorë vendimtarë për lirinë dhe çlirimin e vendit e në bazë të cilit paditëses i ishte njohur e drejta në pension të skemës Viktimë Civile e Luftës.

Neni 23 i cili ka të bëjë me zbatimin e këtij ligji, në paragrafin 2, përcakton se: *“Shfrytëzuesit e pensionit bazë, mund të realizojnë të gjitha të drejtat dhe beneficionet e përcaktuara me këtë ligj, nëse i përmbushin kushtet dhe kriteret sipas dispozitave të këtij ligji”.*

Gjykata gjeti se në lidhje me të drejtën e pranimin të dy pensioneve, u bazua edhe në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme nën shenjë ARJ.NR.77/2021 të datës 11.08.2021, me ç’rast Gjykata Supreme kishte konstatuar se paditësi i kishte përmbushur kushtet ligjore për njohjen e së drejtës në pension të Invalidit Civil të Luftës si dhe të drejtën në pension bazë dhe kontributpages të moshës në bazë të kontributeve të paguara gjatë punës. Me këtë rast, gjykata Supreme kishte gjetur se aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta nuk janë përfshirë në shkelje procedurale apo me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata po ashtu, me qëllim që të përcaktohet vlera e saktë e kompensimit e cila duhet të paguhet nga data e ndërprerjes së këtij pensioni, me kërkesën e përfaqësuesit të palës paditëse me aktvendimin A.nr.280/23 të datës 06.12.2023, ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare e cila i është besuar Ekspertes Financiare E.. A...

Nuk është kontestuese se paditësja i ka përmbushur të gjitha kushtet dhe kriteret sipas këtij ligji për njohjen e Pensionit të skemës Viktimë Civile e Luftës. Po ashtu, nuk është kontestuese se paditësja që nga data 08.01.2013, ka filluar të shfrytëzoj të drejtën e pensionit bazë, për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare.

Me vendimin e shkallës së parë, është shfuqizuar Vendimi nr.227524 i datës 08.01.2023, që nënkupton vendimin e pensionit bazë dhe paditëses i është ndërprerë pagesa e mëtejme e Pensionit Bazë, me arsyetimin se paditësja është duke shfrytëzuar të drejtën në Pension të pension të skemës Viktimë Civile e Luftës, si e drejtë më e favorshme për përfituesin. Vendimi i tillë del të jetë përveç kontradiktor me vetveten edhe në kundërshtim me provat e administruara.

Në këtë kuptim dhe në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, gjykata vlerëson se e paditura, me vendimin e shkallës së parë dhe rrjedhimisht me vendimin e shkallës së dytë, ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për faktin se paditësja

sipas Vendimit të datës 18.01.2013, fillimisht ka qenë shfrytëzuese e Pensionit Bazë, të cilin vendim e ka shfuqizuar e paditura, e që sipas dispozitës së lartcekur, të njëjtës i takon edhe e drejta në shfrytëzimin e pensionit të skemës Viktimë

Civile e Luftës. Në këtë mënyrë, gjykata vlerësoi se ligji është zbatuar në dëm të paditëses, andaj edhe padinë e konsideroi të bazuar dhe vendosi çështjen në mënyrë meritore, konform nenit 43.3 të LKA-së.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurës sa i përket nenit 16 të Ligji Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, i cili përcakton se: *“personat të cilët janë përfitues të të cilit do pension të Skemave pensionale të përcaktuara me këtë ligj, nën asnjë rrethanë nuk mund të jenë përfitues të ndonjë pensioni nga skemat e veçanta pensionale të cilat menaxhohen dhe administrohen nga Ministria”*.

Lidhur me këtë gjykata konsideron se kjo dispozitë nuk mund të aplikohet për rastin e paditëses, ngase e drejta e paditëses është garantuar me nenin 23 par.1 të Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre, si ligj i veçantë apo *“lex specialis”*, i cili nuk është shfuqizuar as me Ligjin Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti apo me ndonjë ligj tjetër.

Pasi që gjykata vërtetoi këto fakte mbi bazën e provave në shkresat e lëndës si dhe në përputhje me dispozitat e ligjeve në fuqi, vlerësoi se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative pranë të paditurës. Duke marr për bazë këtë, gjykata ka vlerësuar se vendimet e të paditurës të shkallës së parë dhe të dytë janë të kundërligjshme dhe si rezultat ka vendosur që paditëses t'i njihet edhe e drejta në Pension Bazë, nga dita kur i është ndërprerë dhe ka vendosur të njëjtës t'i bëhet kompensimi në emër të kësaj të drejte në mënyrë retroaktive pasi që baza juridike e kërkesëpadisë është krijuar me anulimin e vendimit për ndërprerjen e kësaj të drejte.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur konform nenit 64 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta.

Andaj, duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43.3, 46.2, lidhur me nenet 5,6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.280/23, datë: 05.03.2024

Gj y q t a r i

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit, përmes kësaj Gjykate.